



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.40/2017

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Faton Ademi, ne çështjen juridike te paditësit:

l Rr. a nr kati Komuna e , kundër te paditurës: Komuna e Drejtoria e Arsimit, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin ne emër te pagave përcjellësepër ne pension, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, me dt. 21.11.2017, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHET e paditura Komuna e Drejtoria e Arsimit t'ia paguajë paditësit l Rr. l nr kati Komuna e e emër te pagesës së 3 pagave përshpërblim jubilar pas pensionimit dhe 3 pagave përcjellëse për periudhën e punës prej 42 vite, 1 muaj dhe 23 dite, shumën totale prej 2416.26 euro, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës kontestimore te gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm

OBLIGOHET e paditura Komuna e Drejtoria e Arsimit t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 25 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 31.01.2017 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe ne emër te 3 pagave përcjellësepër ne pension.

Gjykata, me dt. 11.10.2017, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar paditësi, dhe përfaqësuesi i të paditurës.

Paditësi në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur me shkrimi propozoi gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ku me rastin e kalkulimit të pagave shumën prej 3400 € e precizoj dhe shumën e kërkuar për tri paga jubilarë dhe

përcjellëse të jetë 2,416.26 € apo 402.71 € paga mujore, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

I autorizuari i të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetem në tërësi pran thëniet gjatë seancës paraprake ku e kundërshton padinë me arsyetimin se paditësja i është drejtuar gjykatës pas afatit të paraparë, kërkoj që lidhur me shpërbilin jubilar gjykata të merë për bazë vlerat të cilat janë të përcaktuara me kontratë kolektive në periudhat e caktuara kohore si dhe duke pasur në vëmendje llogaritjen e stazhit të punës të cilin në nivelin qendror procedohet nxjerrja e ligjit të veçantë për njohjen e stazhit të punës në kohën e suprimimit të institucioneve arsimore ashtu që i propozojmë gjykatës që vendimin ta marrë në bazë të provave, shpenzimet procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës i datës 26.01.2017, kopja e letër njoftimit të paditëses, transaksioni në llogarinë e paditëses për periudhën 01.07.2014 e deri me 31.12.2014, vërtetimi për përvojën e punës i datës 27.10.2014, vendimi i datës 24.10.2014, përgjigja nga departamenti i Administratës Pensionale e datës 29.10.2014, vendimi i datës 14.11.2014, vendimi i datës 06.06.2016, kopja e librit amë dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti që paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të paditura nga datat: 02.09.1972 deri me 23.10.2014, ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nr.268/14 të datës: 24.10.2014.

Nga vërtetimi nr. 268/14 të datës: 24.10.2014 vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në shkollën e mesme të ultë " " në periudhën 01.09.1972 deri me 23.10.2014.

Nuk është kontestues fakti se me vendimin MPMS-Departamenti i Pensioneve paditësi është shfrytëzues i pensionit kontributiv në shumë prej 140 euro që nga data e pensionimit.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 402.71 euro ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë për periudhën 01.07.2014 deri me 31.10.2014, ku shihet qartë se paga ka qenë ajo që përmendet me lartë.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës se paditësja i është drejtuar gjykatës pas afatit të paraparë, pretendimet e lartcekura gjykata nuk

mund ti aprovoj si të bazuar dhe atë duke u bazuar në Ligjin e Punës ma saktësisht në nenin 87 i cili thotë citoi "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", e paditësja ka dal në pension me datë 23.10.2014 ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 31.01.2017 ashtu qe ka vepruar brenda afatit kohor dhe nuk ka arritur parashkrimi.

Ndërsa sa i përket asaj se lidhur me shpërbilin jubilar gjykata të merë për bazë vlerat të cilat janë të përcaktuara me kontratë kolektive në periudhat e caktuara kohore si dhe duke pasur në vëmendje llogaritjen e stazhit të punës të cilin në nivelin qendror procedohet nxjerrja e ligjit të veçantë për njohjen e stazhit të punës në kohën e suprimimit të institucioneve arsimore, gjykata lidhur me pretendimet e lartcekura e sqaron faktin se në kohën e vendosjes nuk kemi një ligj qe e njuhë stazhin e punës andaj duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar nga institucioni ku ka punuar me nr. të datës: 24.10.2014, si dhe nga provat tjera të cilat gjinden në shkresa të lëndës paditëses i njihet stazhi i punës në total prej 42 vite e një muaj e 23 ditë.

Gjykata për vendosje sipas pikës 1 te dispozitivit sa i përket pagesës se tri pagave ne emër te shpërblimit jubilar iu referua nenit 36 par 9 nën par. 9.3 dhe 9.4 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës me te cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi i fundit t'i njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne vlere-lartësia te tri pagave mujore te tij" ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ne emër te kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua ne nenin 10 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës me te cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse te tri pagave mujore qe i ka marre ne tre muajt fundit.

Bazuar ne nenin 36 par.9.4 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës është detyrim i punëdhënësit te fundit këtu te paditurës qe ti paguaj kompensimin për dy kategori te lartcekura.

Gjykata kur ka vendosur sipas pikës 1 te dispozitivit sa i përket pagesës se tri pagave ne emër te shpërblimit jubilar, përveç Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës, iu referua edhe nenit 52 par 1 nën par 1.3 te Marrëveshjes se përgjithshme kolektive te datës 18.03.2014, me te cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne vlere-lartësia te tri pagave mujore te tij" ndërsa gjykata me

rastin e vendosjes ne emër te kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua ne nenin 53 te marrëveshjes kolektive me te cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse te tri pagave mujore qe i ka marr në tre muajt fundit.

Gjykata, lidhur me përlogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 382 par 2 të LMD-se.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve 25 euro ne emër te taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.40/17 data 21.11.2017

GJYQTARI
Faton Ademi



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.

exp. Pateve
21.11.2017 JS

15.12.2017

